REPUBLIKA E KOSOVËS /REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

01nr 112102 -35384
Dt: 21.12.2018

Kryetari i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, me qëllim të themelimit të komisionit për vlerësimin e punimeve të kryera në pendën në fshatrat Duzhnje dhe Babaj Bokës në Komunën e Gjakovës, me datë: 21.12.2018, e mori këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për vlerësimin e punimeve të kryera në pendën fshatrat Duzhnje dhe Babaj Bokës në Komunën e Gjakovës, në këtë përbërje:

1. Riza Morina, Kryesues
2. Elvane Qarkaxhija, anëtare
3. Bujar Muhaxhiri, anëtar

2. Komisioni i përshkruar sipas pikës 1 të angazhohet për realizimin e procesit të vlerësimit të punimeve në tenderin e pendës në fshatrat Duzhnje dhe Babaj Bokës, dhe të harton dokumentet zyrtare me të dhënat për konstatimin e gjendjes faktike, të cilin duhet t'ia përcjell për njoftim Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Zyrës së Prokurimit dhe operatorëve ekonomikë " King Holding" sh.p.k & " Eurocom" sh.p.k &- Gjakovë, i cili i ka realizuar punimet në siç janë përshkruar në kontratën me nr. 02-710/04-19136 të datës 29.08.2017.

A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës – Zyra e Prokurimit dhe " King Holding" sh.p.k & " Eurocom" sh.p.k &- Gjakovë, kanë lidhur kontratë me datën 29.08.2017 me numër 02-710/04-19136, për Intervenimin në mirëmbajtje, renovim dhe rindërtimin e pendës dhe kanalit në zonën rurale, në fshatrat Duzhnje dhe Babaj Bokës.

Si organ mbikëqyrës për pranimin e punimeve është i kontraktuar nga Komuna e Gjakovës firma " AL-Engineering" & "Project Plus", ndërsa menaxher i projektit dhe përgjegjës që përcjell implementimin e kontratës është Rexhë Rexha.

Organi mbikëqyrës ka informuar Komunën e Gjakovës. përkatësisht Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, përmes emalit të cilat gjenden në shkresat e lendes, se me operatori ekonomik të cekur me lartë ka një konflikt verbal (fjalosje) dhe për shkak rrethanave të cilat janë krijuar në mes palëve është e pa mundur pranimi punimeve nga organi mbikëqyrës andaj, Kryetari i Komunës emëron komisionin sipas pikës 1 të këtij vendimi i cili do ti kryen detyrat të përshkruar si në dispozitiv.

Nga theksimet e lart cekura u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetarit i Komunës.

Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të Komisionit
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
- Zyrës së Prokurimit
- Operatorëve Ekonomik
- Arkivit

Kryetari i Komunës së Gjakovës

Ardian Gjini